Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0975

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amandamentuar me dt. 09. 08. 2023 në përbërje nga Vedat Poterqoi -Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.SH.T "NeraMed", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të SHSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Barna nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-së (110)" me numër të prokurimit 00220-23-9623-1-1-1, me 27/12/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE N.SH.T "NeraMed" me nr. 2023/0975, e datës 04/12/2023, kurse vendimi i AK SHSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Barna nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-së (110)" me numër të prokurimit 00220-23-9623-1-1-1 për LOT 13 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.SH.T "NeraMed". OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 11.09.2023 SHSKUK - Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me Barna nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-se (110) LOT 13" me nr. të prokurimit: "00220-23-9623-1-1-1"

Me datën 16.11.2023 AK, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës të këtij aktiviteti të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë kornizë, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 75,000.00 €.

Me 22.11.2023 OE "N.SH.T "NeraMed" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK të cilën me datën 24. 11. 2023 e ka refuzuar autoriteti kontraktues.

Me 04.12.2023, OE "NeraMed" ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 975/23 lidhur me aktivitetin e sipërcituar të prokurimit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Konstatimet e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim të OE "NeraMed"

Përgjigje nga Autoriteti Kontraktues lidhur me pretendimin ankimor 1, 2, 3 dhe 4: Lidhur me pretendimet e Operatorit ekonomik se lënda është kthyer në Rivlerësim dhe AK ka dërguar Leter standarde për tenderët jo normalisht te ulët ku ka pranuar shkresën nga OE i rekomanduar me zbërthim detal te Çmimit të ofruar, Lidhur me pretendimi për variacion te produktit këtu nuk kemi te bëjmë fare me një variacion te produktit po me ndryshimi tregtar i emrit te prodhuesit apo holderit te AM ku është 1 dokumentuar ne ofertën e OE te rekomanduar. Deri sa një produkt ka AM valide nga AKPM-ja atëherë ai produkt mund te qarkulloi lirshëm ne Tregun e Kosovës dhe ne dokumentet e prezantuar te OE te Rekomanduar shihet qe OE ka prezantuar AM valide. Përfundim: Në bazë të arsyeve të lartcekura Autoriteti Kontraktues refuzon këtë kërkesë për rishqyrtim si të pa bazuar. Për ne të gjithë Operatoret Ekonomik janë të rëndësishëm dhe të barabartë. Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë pranë OSHP-së.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "NeraMed" janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se:* "Fillimisht, me datën 09/11/2023 ne si OE kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim ne AK – ShSKUK ku e njëjta kërkesë është aprovuar si e bazuar dhe lënda është kthyer ne rivlerësim, por përkundër këtij fakti AK - ShSKUK përsëri rekomandon për dhënie te kontratës operatorin ekonomik te papërgjegjshëm ne aspektin e ofertës financiare dhe ne aspektin e kërkesave te kapacitetit teknik, profesional dhe përshtatshmërisë profesionale. OE "Neramed" Sh.P.K. përsëri me datën 22/11/2023 paraqet kërkesë për rishqyrtim por tani AK – ShSKUK refuzon kërkesën tone dhe le ne fuqi

vendimin – propozimin për dhënie te kontratës përkundër faktit se kompania jone ka prezantuar prova konkrete përmes te cilave vërtetohet se OE i propozuar për dhënie te kontratës ne lotin 13 te procedurës se prokurimit me titull "Furnizim me Barna nga Lista Esenciale për Nevojat e SHSKUK-së (110) – Lot 13 – Tretësire për injeksion 250mcg/5ml, ka edhe kërkesa kualifikuese" është e papërgjegjshme. AK – ShSKUK sipas vendimit – refuzimit te kërkesës te datës 24/11/2023 ka shkelur paragrafin 8, pika 8.4 te nenit 108A te LPP-se, përkatësisht nuk e ka trajtuar asnjërin nga pretendimet tona ankimore. 8. Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.4 Autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.

- *Pretendimi i dytë (II), Ankuesi pretendon se:* AK fillimisht me datën 06.11.2023, ka publikuar formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e AK-se, ku për lotin 13– "Tretësire për injeksion 250mcg/5ml", ka rekomanduar për dhënie te kontratës OE "Agro Med", i cili ka prezantuar me oferte te pa përgjegjshme. OE ankues "Neramed"shpk, me datën 09.11.2023, ka parashtruar kërkese për ri shqyrtim, ku ne si kompani kemi prezantuar fakte dhe dëshmi ku është vërtetuar se OE te cilin AK e ka rekomanduar për dhënie te kontratës ne lotin 13, është i pa përgjegjshëm. Fillimisht AK - ShSKUK ka aprovuar kërkesën tone si te bazuar lenden e ka kthyer ne rivlerësim, çuditërisht me datën 18.11.2023, përsëri e rekomandon për dhënie te njëjtin OE duke i anashkaluar pretendimet tona ankimore dhe duke tentuar te lidhe kontrate me OE, i cili nuk mund te beje as importin e produkteve. Ne dosje te tenderit ne piken 4.1 është përcaktuar se Variantet NUK janë te autorizuara dhe AK nuk mund te lidhe kontratë me variant te produktit apo me variant te prodhuesit.
- *Pretendimi i tretë (III), Ankuesi pretendon se:* Autoriteti Kontraktues – SHSKUK, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional ne piken 9.1& 9.2 pozicioni 1 ka kërkuar: Kërkesa 1. Autorizim nga prodhuesi për pjesëmarrje në ketë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesit. Në rast të autorizimit nga përfaqësuesi-dileri, kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi. Si dëshmi dokumentare – evidence është përcaktuar: Evidenca 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje ne ketë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi- me nr prokurimi te kësaj procedure (me te dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, ëeb faqja etj, për mundësi te verifikimit). Ne rast te autorizimit nga përfaqësuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi", ndërsa ne piken 2 është kërkuar Autorizim për Marketing ne Kosove nga AKPPM. Operatori Ekonomik te cilin AK – SHSKUK, po tenton ta rekomandoje për dhënie te kontratës "Agro Med" shpk, përsëri përkundër faktit se lenden e ka kthyer ne ri vlerësime, ka ofertuar me produktin e prodhuesit "Haver Trakya ilaç san. Vetic" ne njërën ane dhe ne anën tjetër për produktin "Tretësire për injeksion 250mcg/5ml, i njëjti OE ka prezantuar "Marketing Autorizimin ne emër te "MS Pharma Ilac ve Ticaret Anonim Sirketi", produkt i regjistruar me datën 09.12.2019, i evidentuar nga AKPPM si mbajtës i AM-se me prodhues "MEFAR Ilac Sanayii A.S Turkey". Kjo çështje është e pa mohushme por çuditërisht nga AK tentohet te manipulohet. Prove: Letër Autorizimin, oferta financiare dhe AM
- *Pretendimi i katërt (IV), Ankuesi pretendon se:* Operatori Ekonomik, i rekomanduar për dhënie te kontratës ne lotin 13, ne oferte ka prezantuar një shkresë nga Regjistri Turk i Bizneseve te datës 28.11.2022, ku është ndryshuar subjekti nga "MS Pharma Ilac ve Ticaret Anonim Sirketi", ne "Haver Trakya ilaç san. Vetic", ndërsa AM nuk është ndryshuar siç kërkohet me dispozita ligjore ne fuqi. Me ligjin nr. 04/L -190, për produkte dhe pajisje medicinale ne nenin 3, pika 1. 44 dhe 1.45 përcaktohet qe: 1.44 Bartësi i autorizim marketingut - një person juridik i cili ka marrë autorizim marketingun për produktin medicinal. 1.45. Përfaqësuesi i bartësit të autorizim marketingut - një person juridik, i njohur zakonisht si përfaqësues vendor, i caktuar nga bartësi i autorizim marketingut që ta

përfaqësojë atë në Republikën e Kosovës; Pra personi juridik i cili ka dhëne autorizim, operatorit ekonomik te rekomanduar për dhënie te kontratës ne lotin 13, "Haver Trakya ilaç san. Vetic", për produktin "Tretësire për injeksion 250mcg/5ml", nuk është bartës i Autorizim Marketingut dhe as prodhues por bartës i AM është "MS Pharma Ilac ve Ticaret Anonim Sirketi" me prodhues "MEFAR Ilac Sanayii A.S Turkey". dhe si i tille nuk i plotëson kërkesat kualifikuese te përcaktuara ne piken 1 dhe 2, te kapacitetit teknik dhe profesional te përcaktuara ne dosje te tenderit. Udhëzimi administrativ nr.01/2015 – Autorizimi për Marketing për Produkte Medicinale neni 6, Dorëzimi i Aplikacionit për Autorizim Marketing paragrafi 5 përcakton: "Aplikuesi është i obliguar të informojë AKPPM-në menjëherë rreth çfarëdo ndryshimi të adresës së qëndrimit, lokacionit të prodhuesit, procesit të prodhimit ose ndryshime tjera që kanë të bëjnë me aplikacionin e autorizim marketingut, që është nën shqyrtim. Pasi të lëshohet autorizim marketingu informata duhet të jepet nga bartësi i autorizimit të marketingut". Për ketë ceshje AK – SHSKUK, është ne dijeni me se miri se me Variant te formës se Autorizim marketingut dhe me Variant te Prodhuesit te produktit nuk mund te ofertohet, po ashtu AK është ne dijeni se ndryshimet ne produkt, ndryshimet e prodhuesit duhet te raportohen ne Ministrinë e Shëndetësisë se Republikës se Kosovës, përkatësisht ne Agjencinë për Produkte dhe pajisje medicinave ne atë mënyre qe AM te ndryshohet, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ne lotin 13 nuk e ka bere një gjë te tille, prandaj oferta e te njëjtit është e papërgjegjshme. Dhe përkundër sqarimeve me larte AK-SHSKUK ka qene e obliguar te kërkojë informacione shtese nga Agjencioni përgjegjës për regjistrim te produkteve medicinale dhe për lëshimin e Licencave te Importit – AKPPM, një gjë te tille AK-SHSKUK nuk e ka bere si duket qëllimshëm.

- *Pretendimi i pestë (V), Ankuesi pretendon se:* Çështja tjetër e cila tregon pa përgjegjshmërinë e ofertës, është vlera e ulet e ofruar nga OE i rekomanduar ne lotin 13 për ketë produkt ku është ofruar vlera prej 4.58 € për njësi, ndërsa AK – SHSKUK, si vlere te parashikuar për ketë produkt ka përcaktuar totalin prej 75,000.00 €, apo 15 €, çmim për njësi. AK -SHSKUK, sipas procesit te rivlerësimit ka abuzuar me dispozita ligjore, ka abuzuar dhe ka fyer kompaninë tone. Çmimi referent i përcaktuar nga ju si AK është 15€, OE ankues ka ofruar çmimin por 4.58€ dhe AK e trajtoni si çmim te mirëqenë, produkt i cili nuk mund te importohet ne rruge ligjore dhe me ngulm AK, Zyra e Prokurimit rrezikon shëndetin publik. AK, përgjatë ri vlerësimit te ofertave doemos ka qen dashur te aplikoni dispozitat e nenit 41 "Tenderët jo normalisht te ulet", paragrafin 41.3 ku përcaktohet: 41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme: i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm; ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët; iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë. OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ne asnjeri rrethane nuk mund te kualifikohet si OE i përgjegjshëm madje qysh ne pragun fillestar do duhej te eliminohej meçe çmimi i te njëjtit OE është me shume se 30 % me i ulet se çmimi mesatar i tenderëve te përgjegjshëm. AK SHSKUK, komisioni vlerësues i ofertave nuk ka aplikuar dispozitat e nenit 61 te LPP-se, nuk ka aplikuar as dispozitat e nenit 41 te RRPP-se. Sipas vendimit te datës 24/11/2023, AK - ShSKUK potencon se ka pranuar shkresën nga OE i rekomanduar me zvogëlim detal te çmimit te ofruar, por ne platformën E-Prokurimi nuk ekziston kurrfarë shkrese dhe kurrfarë komunikimi lidhur me këtë çështje. Dispozitat e LPP-se dhe rregullat tjera e obligojnë AK-ne qe te gjitha komunikimet te bëhen përmes platformës e-prokurimi.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/12/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 975/23, ndërsa me datë 15/12/2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/0975 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim".

Lidhur me pretendimet e OE "NeraMed" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0975 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I):* Eksperti shqyrtues vlerëson se kthimi ne rivlerësim sipas nenit 40.2 te RRPP 001/2022 Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar. AK-ja gjatë procedurës se rivlerësimit ka sqaruar pretendimin për çmime jo-normalisht te ultë me anë të letrës standarde për informata jo-normalisht të ultë te datës 13.11.2023 por qe sqarimi nuk ka reflektuar ne raportin e komisionit të rivlerësimit te datës 16.11.2023. Gjate arsyetimit te çmimit jo normalisht te ultë OE i rekomanduar për kontratë kishte dërguar edhe një kërkesë për konfidencialitet ku ka përfshirë sqarimin e dhënë per zbërthimin e çmimit si sekret afarist. Ndërsa sa i përket kërkesës për rishqyrtim te datës 24.11.2023 dhe pretendimit se AK nuk e ka trajtuar asnjërin nga pretendimet e OE ankues eksperti shqyrtues vlerëson se AK me vendimin e datës 24.11.2023 i ka refuzuar si te pabazuara te gjitha pretendimet e OE ankues. Përkundër faktit se eksperti shqyrtues vlerëson se nuk janë adresuar te gjitha pretendimet konkrete, sidoqoftë i është dhënë një përgjigje e përgjithshme. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka vepruar në përputhje me Nenin 60 te RRUOPP në lidhje me Neni 63.1.1 a) si dhe nenin 63.2 te RRPP 001/2022 dhe se pretendimi në këtë pikë nuk është i bazuar. Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE ka deklaruar se pajtohet me raportin e ekspertes shqyrtuese.
- *Konstatimi i dytë (II):*Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me kërkesën 9.1 & 9.2 për kapacitetin teknik dhe profesional eksperti shqyrtues sqaron se sipas dosjes se tenderit është kërkuar: Kërkesa 1. Autorizim nga prodhuesi për pjesëmarrje në ketë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesit. Në rast të autorizimit nga përfaqesuesi-dileri, kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi. Evidenca 1. Autorizimi nga prodhuesi për pjesëmarrje ne ketë tender ose nga përfaqësuesi i autorizuar nga prodhuesi- me nr prokurimi te kësaj procedure (me te dhëna mbi prodhuesin adresa, nr. tel, email, ueb faqja etj, për mundësi te verifikimit). Ne rast te autorizimit nga përfaqësuesi-dileri kërkohet edhe autorizimi i dilerit nga prodhuesi. OE i rekomanduar për kontratë me ofertë ka dorëzuar autorizimin e prodhuesit të lëshuar nga "Haver Trakya ilaç sanayi Vetic" për produktin PALONEX 250 MCG 5 ML IV SOLUTION FOR INJCETION (palonosetron hydrochloride). Ne ofertë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatën për

Autorizim të marketingut me nr. MA No: MA-5953/09/12/2019 në emër te: MS Pharma Ilac Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi për produktin me emër tregtar PALONEX me INN: Palonosetron HCI* (Equivalent to 0.050 mg/ml Palonosetron) në të cilën si prodhues është deklaruar: MEFAR Ilaç Sanayii A.S., Turkey. Vlen të theksohet se emri tregtar "MS Pharma Ilaç San. ve Tic. A.S" me kërkesën e aplikuesit me nr. E-62820468-000-952720 ishte ndryshuar ne mënyrë te rregullt në regjistrin tregtar në "Haver Trakya Ilaç San. ve Tic. A.S" nga Ministria e Shëndetësisë se Republikës se Turqisë.

- *Konstatimi i tretë (III):* Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me ndryshimin e emrit tregtar dhe të dhënat e OE në Autorizim Marketing eksperti shqyrtues vlerëson se i janë dhënë përgjigje ne pretendimin 3 dhe 4 dhe rrjedhimisht nuk do te shqyrtohen këtu.
- *Konstatimi i katërt (IV):* Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka të bëjë me çmime jo-normalisht të ultë eksperti shqyrtues sqaron se e njëjta është shtjelluar edhe ne përgjigjen nr 1 të pretendimit por qe shton se AK-ja në përputhje me nenin 41.3 dhe 41.6 te RRPP 001/2022 e ka trajtuar ofertën e OE te rekomanduar për kontratë dhe për te cilën ka marrë përgjigje nga OE i rekomanduar për kontrate me datën 15.11.2023. AK-ja e ka trajtuar sqarimin ne përputhje me Nenin 41.3 te RRPP 001/2022 dhe rrjedhimisht edhe ka marre përgjigje. Në bazë të Nenit 41.10 te RRPP 001/2022 41.10 Pasi që Autoriteti kontraktues merr shpjegimin me shkrim nga Operatori Ekonomik, Autoriteti Kontraktues duhet ose: a. Nëse sqarimi është i mjaftueshëm, të trajtoj tenderin njëjtë me tenderët tjerë; b. Nëse sqarimi nuk mjafton, të refuzoj tenderin dhe, në përputhje me nenin 61 të LPP-se të njoftoj KRPP, duke përdorur formën standarde të miratuar nga KRPP, "Njoftim për refuzim të tenderit jo normalisht të ulet", brenda dy dite nga data e vendimit. Prandaj bazuar në dokumentet e administruara eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor në këtë pikë nuk është i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar lidhur me mendimin dhe konstatimet e dhëna në raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Nga sqarimet e dhëna më sipër, konkuldohet se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "NeraMed". Argumentimi në raportin e ekspertizës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e dhëna mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale,

rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

-Përfundim-

Konform pretendimeve ankimore dhe përgjigjeve të dhëna nga autoriteti kontraktues pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, shihet se AK gjatë ekzaminimit të kësaj procedurë të prokurimit nuk ka vepruar sikurse parasheh neni 59 i LPP-së.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**
- OE - **N.SH.T " NERAMED "**
- Arkivës së OSHP-së: